



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 77

Tiranë – E mërkurë, 12 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 36/2017, datë 6.4.2017	Për miratimin e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negocimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.-së”, si edhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016.....	4775
Vendim i Kuvendit nr. 37/2017, datë 6.4.2017	Për emërimin e zotit Ervin Koçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.....	4775
Vendim i Kuvendit nr. 39/2017, datë 6.4.2017	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	4776
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 5.4.2017	Për financimin e pistës së atletikës në stadiumin “Loro Boriçi”, Shkodër	4776



**VENDIM
Nr. 36/2017**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT
PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT “PËR
HETIMIN DHE VERIFIKIMIN E
ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË
FUQI, MBROJTJEN E INTERESIT TË
SHTETIT SHQIPTAR GJATË
PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES, NEGOCIMIT TË
MARRËVESHJES SË SHITJES SË
AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR.
10 116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN
E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR
QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT
TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
(OSSH) SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË
SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE CEZ A.S.-SË”, SI
EDHE EVIDENTIMIN E EFEKTEVE
NEGATIVE FINANCIARE TË
SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E
ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”,
NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 30/2016**

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, dhe të nenit 22, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negociimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.-së”, si

edhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raporti Përfundimtar i komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negociimit të Marrëveshjes së Shitjes së Aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.-së”, si edhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje” i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e çështjes penale.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 6.4.2017

**VENDIM
Nr. 37/2017**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT ERVIN KOÇI
NË DETYRËN E ANËTARIT TË BORDIT
TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE, QË DO TË MBAJË
FUNKSIONIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Emërimin e zotit Ervin Koçi si anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe që do të mbajë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit për periudhën e mbetur të mandatit të anëtarit të liruar nga kjo detyrë. Periudha e mbetur e mandatit përfundon në datën 24.12.2019.



II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 6.4.2017

VENDIM
Nr. 39/2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 5/2015, “PËR ÇAKTIMIN
E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015, “Për çaktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Petrit Gjoni caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 6.4.2017

VENDIM
Nr. 302, datë 5.4.2017

PËR FINANCIMIN E PISTËS
SË ATLETIKËS NË STADIUMIN
“LORO BORIÇI”, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 27, të ligjit nr.9376, datë 21.5.2005, “Për sportin”, të ndryshuar, të neneve 30 e 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin në masën 75 498 727.92 (shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, për projektin “Ristrukturimi i pistës së atletikës, pjesë e stadiumit “Loro Boriçi”, Shkodër.

2. Fondi i miraturar në masën 75 498 727.92 (shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë nga fondet e buxhetit të shtetit, për projektin “Ristrukturimi i pistës së atletikës, pjesë e stadiumit “Loro Boriçi”, Shkodër, të transferohet në formë granti nga llogaria ekonomike 604, programi buxhetor 08140 “Zhvillimi i sportit”, me përfitues Federatën Shqiptare të Futbollit në llogarinë bankare, në bankë të nivelit të dytë.

3. Fondi prej 75 498 727.92 (shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë për financimin e projektit “Ristrukturimi i pistës së atletikës, pjesë e stadiumit “Loro Boriçi”, Shkodër, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Federata Shqiptare e Futbollit dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë